



**TABELA E PERMBAJTJES**

<b>I. POLITIKAT E PARANDALIMIT .....</b>	<b>2</b>
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>2</b>
1.1 QELLIMI .....	2
1.2 Kuadri rregullator .....	2
1.3 Fushëveprimi dhe detyrimi i parandalimit .....	2
<b>2. PARIMET E PERGJITHSHME .....</b>	<b>3</b>
<b>3. SHTRIRJA E PARANDALIMIT .....</b>	<b>3</b>
<b>4. MBROJTJA E ANONIMITETIT .....</b>	<b>3</b>
<b>II. PROCEDURA E RAPORTIMIT .....</b>	<b>4</b>
<b>1. DHENIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE PER RAPORTIMIN E SHKELJEVE .....</b>	<b>4</b>
<b>2. MENAXHMI I RAPORTIMIT TE SHKELJEVE .....</b>	<b>5</b>
<b>3. FORMULAR DEKLARIMI .....</b>	<b>6</b>



## **I. politikat e raportimit te shkeljeve**

### **1. Parathënie**

#### **1.1 Qellimi**

Kjo Politikë përcakton parimet dhe kornizën përmes së cilës Alpha Bank Albania (në tekstin e mëtejshëm referuar "Banka") merr, vlerëson dhe heton raportime anonime dhe jo-anonime mbi parregullsi serioze, mosveprime ose ofendime që vihen në vëmendje të Personelit të saj, Klientëve, ose furnitorëve.

Njëri prej angazhimeve me të mëdha të Bankës është të ruajë nivelin më të lartë të etikës dhe sjelljes profesionale, duke patur një tolerancë zero ndaj veprimeve të paligjshme dhe të parregullta që ndikojnë në prestigjin dhe besueshmërinë e saj.

#### **1.2 Korniza rregullatore**

Politika e raportimit të shkeljeve (ketu e ne vijim "Politika") bën pjesë në dispozitat e Aktit të Guvernatorit të Bankës së Greqisë, akti me nr. 2577 / 9.3.2006 për "Kornizën e parimeve operative dhe kriteret për vlerësimin e organizatës dhe Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm të institucioneve të kreditit dhe financave dhe kompetencave përkatëse të organeve të tyre drejtuese", në fuqi.

#### **1.3 Qellimi I politikës së raportimit të shkeljeve dhe detyrimi**

Kjo Politikë vlen për të gjitha Kompanitë e Grupit, përfshirë Kompanitë e Grupit jashtë që kanë të bëjnë me politikën perkatese të raportimit të shkeljeve, e përafëruar me parimet dhe legjislacionin vendas, që mund të ekzistojnë në baze të dispozitave rregullatore të zbatueshme në vendin në të cilin çdo shoqëri është aktive dhe ushtron veprimtarinë e saj.

Procedura e raportimit të shkeljeve I adresohet të gjithë personelit, të gjithë klienteve si dhe kujtdo që i ofron shërbime Bankës dhe është përcaktuar për të zbatuar Rregulloren e Personelit dhe Qarkoret e Bankës në lidhje me detyrat e përgjithshme të Punonjësve.

Në vecanti, detyrimi I raportimit anonim ose jo anonim të shkeljeve zbatohet për personat e mëposhtëm:

- Anëtarët e Bordeve të Drejtorëve.
- Menaxherët.
- Personat e caktuar si Këshilltarë.
- Punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm.
- Personat dhe kompanitë që bashkëpunojnë me Bankën në bazë të kontratave të punës.
- Furnizuesit.
- Konsumatorët.
- Cdo palë e tretë që posedon prova dhe / ose informacion mbi veprime të parregullta / të paligjshme (të cilat janë kryer ose mund të jenë kryer) që i përkasin Bankës dhe Grupit.

## **2. PARIMET E PERGJITHSHME**

Politika e zbatuar përbën një mjet për të siguruar integritetin, prestigjin dhe reputacionin e Bankës. Kontribuon në identifikimin e rreziqeve dhe në miratimin e masave korrektuese të duhura (p.sh. forcimin e sistemit të



kontrollit të brendshëm, zbulimin e hershëm të incidenteve të mashtrimit ose veprave të tjera të rënda, sanksionet e zbatuara ndaj palëve përgjegjëse, njoftimin e autoriteteve kompetente, sipas rastit).

Per te siguruar një mjedis te besueshem dhe te sigurte për Personelin, Konsumatorët dhe Furnizuesit e tyre, Banka inkurajon zbulimin në "mirëbesim" e veprimeve të paligjshme ose veprave të rënda, të cilat vijnë në vëmendjen e tyre.

Një nga parimet kryesore dhe te pacenueshme te kesaj politike është mbrojtja e anonimitetit dhe konfidencialitetit të të dhënave personale të personave që paraqesin raporte të tilla dhe, në rast se ata janë Punonjës të Bankës, mbrojtja e pozitës së tyre aktuale ose zhvillimi i tyre i ardhshëm profesional.

Nuk ekziston ndonje shperblim per raportimin e shkeljeve dhe raportet përkatëse dorëzohen në kontekstin e zbatimit të kornizës institucionale dhe rregullatore (Akti i Guvernatorit të Bankës së Greqisë nr. 2577 / 9.3.2006) nga njëra anë dhe mbrojtja e interesave të Bankës, Kompanive të Grupit, Aksionarëve dhe Konsumatorëve nga ana tjetër.

Procedura e raportimit te shkeljeve synon forcimin e transparencës, e cila inkurajon zbulimin e incidenteve që shkaktojnë dyshime për shkelje serioze të procedurave dhe politikave të Bankës, si dhe zbulimin e incidenteve të mashtrimit, korrupsionit, shtrëngimit apo shkeljeve të tjera.

## **2. QELLIMI I POLITIKES TE RAPORTIMIT TE SHKELJEVE**

Cdo zbulim informacioni do të bëhet me kusht qe te ekzistojte nje element i besueshëm dhe i arsyeshëm se një vepër penale ose shkelje eshte kryer ose mund të kryhet ne te ardhmen. Personeli, Konsumatorët ose Furnizuesit e Bankës inkurajohen të bëjnë deklarime për shkelje, raste të sjelljes së dyshuar të paligjshme, incidente keqmenaxhimi ose parregullsi-shkelje serioze në lidhje me rregulloret, politikat dhe procedurat, si dhe në lidhje me raportimin financiar dhe përgatitjen e Pasqyrave Financiare të Bankës, si me poshte:

- Veprime që përfshijnë neglizhencën e rende, mashtrimin e mundshëm ose korrupsionin.
- Veprime që cenojnë qëllimin dhe reputacionin e Bankës.
- Veprime që bien ndesh me interesat e Bankës.
- Shkelje serioze të politikave dhe procedurave, të cilat mund të rezultojnë në humbje financiare.
- Parregullsi serioze si dhe shkelje serioze që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të investimeve ose përfshirjen në aktivitete investimesh.
- Veprime që fyejne seriozisht kodin e praktikës etike të Bankës dhe veçanërisht Kodin e Etikës.
- Veprimet që rrezikojnë sigurinë e një punonjësi.
- Ofrimi ose pranimi i ryshfetit.
- Veprimet qe demtojne për mjedisin.

Mosmarrëveshjet qe kane per objekt marrëdhëniet e punës duhet të adresohen në përputhje me dispozitat e Rregullores së Personelit të Bankës.

Për më tepër, ankesat e klientëve që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Banka menaxhohen nga Seksioni kompetent i Sigurimit të Cilësisë dhe nuk i nënshtrohen kësaj Politike.

## **3. RUAJTA E ANONIMITETIT**



Dhenia e informacioneve anonime mund të kryhet me telefon, me shkrim, me telefax, me SMS ose me postë elektronike. Në çdo rast, të veprsh në mirëbesim d.m.th. të kesh besim të fortë në lidhje me legjitimitetin e një dhenie informacioni është një parakusht. Dhenia e informacioneve të tilla mbrohet kundër çdo veprimi hakmarrjeje ose masash ndeshkimore, domethënë:

- Identiteti i dhenesit të informacionit, në rast se dhenesi i informacionit ka zgjedhur të mos jete anonim, do të mbrohet dhe do të respektohet konfidencialiteti.
- Dhenia e informacionit u komunikohet vetëm personave të paracaktuar, që konsiderohet i domosdoshëm për hetimin e çështjes dhe të cilët, në përputhje me detyrat e tyre, kanë të drejtë të veprojnë brenda kufijve të gjykimit dhe konfidencialitetit. Në këtë mënyrë, personat që mund të jenë objekt i informacionit të dhene janë të mbrojtura deri hetimi i incidenteve reale është përfunduar.

Grupi siguron që personi që raporton ndonjë shkelje, do të mbrohet siç duhet nga ndikimi i mundshëm negativ, p.sh. hakmarrja, diskriminimi ose çfarëdo forme tjetër e trajtimit të padrejtë dhe se asnjë anetar i komitetit të raportimit të shkeljeve nuk do të ketë ne objektiv raportuesin e shkeljes.

Për më tepër, Grupi siguron që personat për të cilët është bërë një zbulim janë të mbrojtur nga ndikimi i mundshëm negativ, në rastin kur një shkelje nuk vërtetohet të jete kryer nga hetimet e bera dhe nuk merren masa ndaj tyre. Në të njëjtën kohë, edhe nëse hetimi çon në një shkelje të provuar dhe që janë marre masa ndaj personave për të cilët është bërë një dhenia e një informacioni, mbrojtja e personave sigurohet kundër efekteve negative të pavullnetshme që tejkalojnë masat që janë marrë nga organet kompetente.

Eshte verejtur që zbulimi i identitetit të dhenesit të informacionit që mund të kërkohet nga një procedurë gjyqësore ose ligjore, në kontekstin e hetimit të mëtejshëm të çështjes.

## **II. PROCEDURAT E RAPORTIMIT TE SHKELJEVE**

### **1. DHENIA DHE MARRJA E RAPORTIMIT TE SHKELJEVE**

Për të lehtësuar hetimin dhe vlerësimin e duhur të çështjes, zbulimet mund të përfshijnë sa vijon, në mënyrë indikative dhe jo në një mënyrë kufizuese:

- Faktet që shkaktojnë dyshime / shqetësime në lidhje me emrat, datat, dokumentet dhe vendndodhjet.
- Arsyeja e paraqitjes së zbulimit të informacionit.

Duhet të sqarohet se zbulimi nuk pritet të përbëjë provë për ndonjë dyshim / shqetësim të dhenesit të informacionit; megjithatë, ai / ajo inkurajohet të zbulojë çdo informacion që ka në dispozicion, në mënyrë që të lehtësojë hetimin e çështjes.

Informacioni me shkrim i dërgohet Punonjesit të Grupit të pajtuesmerise, i cili është përgjegjës për informimin e anëtarëve të Komitetit të raportimit të shkeljeve.

Dhenia e informacioneve behet nepermjet telefonit ne numrat e vendosur ne dispozicion prane divizionit te pajtuesmerise:

telefon: +30 210 326 2480, SMS at +30 697 330 0006 or nepermjet adreses se postes elektronike ne [whistleblowing@alpha.gr](mailto:whistleblowing@alpha.gr) ose nepermjet postes tek divizioni I Pajtuesmerise (4, Rruga Themistocleous, GR-106 78 Athine, Greqi), dhe ne vemendje te nenpunesit te grupit pajtuesmerise. Të gjitha kanalet e lartpërmendura funksionojnë ekskluzivisht si një linjë e dedikuar për dhenien e informacioneve dhe janë në



dispozicion 24 orë në ditë / ne shtatë ditë te javës. Dhenia e informacioneve ne rruge telefonike do të përgjigjen me postë zanore dhe do të regjistrohen dhe dorëzohen në komitetin e raportimit te shkeljeve nga punonjesi I grupit te pajtueshmerise.

Dhenia e informacioneve mund të zhvillohet në vend, si dhe në numrat e dedikuar të Departamentit të Pajtueshmërisë: përmes telefonit: +355 422 78 551, me SMS në +355 69 60 57 461 ose me postë elektronike në [compliance.albania@alpha.gr](mailto:compliance.albania@alpha.gr), ose me postë në Departamentin e Pajtueshmërisë (Departamenti i Pajtueshmërisë se Alpha Bank Albania, Qendra e Biznesit G-KAM, kati 2, Rruga e Kavajës Tiranë, Shqipëri). Qasja në të dhënat e raportimit te shkeljeve i jepet rreptësisht vetem personelit në nevojë të bazave te informacionit, në përputhje me kapitullin vijues të kësaj politike dhe vetëm për qëllime të menaxhimit të politikave te raportimit te shkeljeve.

## **2. MENAXHIMI I RAPORTIMIT**

Komiteti i raportimit te shkeljeve eshte informuar per te gjitha informacionet e paraqitura nga punonjesi I grupit te pajtueshmerise, persa I perket bankes. Ne rast se raportuesi I informacionit ka perdorur nje kanal informacioni vendas, nenpunesi I grupit te pajtueshmerise informohet nga drejtuesit kompetente te bankes dhe informojne komitetin e raportimit te shkeljeve ne perputhje me rrethanat.

Rrjedhimisht, Komiteti procedon me një vlerësim fillestar të zbulimit te informacionit dhe caktimin e tyre pranë njësite kompetente të Grupit për hetime të mëtejshme. Komiteti i raportimit te shkeljeve informon për secilin rast Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve, i cili mund të sigurojë udhëzime të mëtejshme.

Komiteti i raportimit te shkeljeve përbëhet nga punonjesi i Pajtueshmërisë së Grupit, Audituesi i Brendshëm i Grupit, Shefi i Divizionit Ligjor dhe Sekretari i Bordit të Drejtorëve dhe kryesohet nga Zyrtari i Grupit te pajtueshmerise.

Ne rast se dhenia e informacioneve I referohet nje anetari te komitetit te raportimit te shkeljeve ose anetari I komitetit te raportimit te shkeljeve ka nje konflikt interesi, atëherë ai anëtar do te terhiqet nga pjesemarrja ne mbledhje dhe do të zëvendësohet nga zëvendësi i tij / saj. Vendimet merren unanimisht.

Komiteti I raportimit te shkeljeve do te vendose nëse informacionet e ardhura përfshijnë parregullsi serioze, mangesi ose vepra penale dhe do t'i referojnë raste të tilla tek Njësite kompetente të Grupit në mënyrë që të procedojnë me ndonjë veprim të mëtejshëm të nevojshëm ose tek Divizioni i Auditimit të Brendshëm në mënyrë që të vazhdojë hetimin, nese do te jete e zbatueshme.

Procesverbali I komitetit te raportimit te shkeljeve dhe rezultatet e hetimit fillestar dhe perfundimtar I komunikohen komitetit te auditimit te bordit te drejtoveve.

Komiteti I raportimit te shkeljeve mund të trajtojë çështje që kanë lindur jashtë procedurës së raportimit te shkeljeve, nëse këto çështje kanë veçori që i referohen nevojës së trajtimit ne menyre të pavarur. Raste të tilla mund të ndodhin, ndër të tjera, përmes procedurës së administrimit të ankesave, përmes kërkesave të Autoriteteve Rregullatore ose përmes ankesave të Konsumatorëve, Furnizuesve dhe Punonjësve përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit.

**FORMULAR DEKLARIMI****PERSHKRIMI**

Përshkruani faktet ose provat faktike që kontribuojnë në konstatimin e veprës së kryer ose parregullsinë, në një mënyrë të kuptueshme, duke siguruar sa më shumë informacione të jetë e mundur. Raportoni çdo shqetësim, person ose persona të përfshirë, arsyet pranuese, periudhën gjatë së cilës u shfaq, personat që mund të ndajnë të njëjtin shqetësim.

NENSHKRIMI	Fakultativ

DATA:	/ /
EMRI:	fakultativ
MBIEMRI:	fakultativ
DIVIZIONI/DEGA	fakultativ
KONTAKTI / TEL NR.	fakultativ
E-mail:	fakultativ

NENSHKRIMI I MARRESIT DHE EMRI I PLOTE	DATA:
PERSHKRIMI I VEPRIMEVE TE METEJSHME:	